

Kosova me Status të Përcaktuar: Republika e Kosovës, apo “EU Commonwealth of Kosovo”

**Shkruan:
Faton H. Bislimi**

**Boston, SHBA
27 Tetor 2005**

Fillimi i Fundit, apo Fundi i Fillimit

Ditë më pare, më 24 Tetor, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara edhe njëherë si temë kryesore të ditës kishte Kosovën. Kësaj rradhe, ndoshta po me aq rendësi sa edhe më 1999 kur kishte vendosur për krijimin e administratës së përkohëshme ndërkombëtare nën patronatin e OKB-së në Kosovën e pasluftës, nën mbrojtjen ushtarake të NATO-s. Atëkohë, nuk ishin të shumtë ata që kishin mundur të paramendonin apo përcaktonin me përpikmëri të duhur fundin e mandatit të Misionit të Përkohëshëm të OKB-së në Kosovë, të njohur si UNMIK. Mirëpo, fatkeqësisht, ky predikim në kohëzgjatjen e mandatit të UNMIK-ut në Kosovë ishte fare vështirë të sigurohej edhe katër, apo edhe pesë vite pas fillimit të këtij misioni. Por, sikur gjithëcka tjetër, edhe UNMIK-ut po arrinë deri tek porta e daljes nga Kosova. Kjo portë veq u hap me Deklaratën Presidenciale të Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 24 Tetor, përmes së cilës iu dha përkrahje e plotë fillimit të procesit të definimit të statusit përfundimtar të Kosovës.

Por, se a po shënohet *fillimi i fundit* të administrimit apo udhëheqjes së Kosovës nga OKB-ja, apo *fundi i fillimit*, mbetet për t'u pare me rezultatet finale të dala nga të ashtuquajturat “negociata” për definimit e statusit përfundimtar të Kosovës. Shumë stëroptimistë mendojnë se me hapat e fundit që ka ndërmarrë Këshilli i Sigurimit, gjithëcka është përgatitur për atë që dëshirojnë dhe aspirojnë shqiptarët e Kosovës. Nuk ka dyshim se vendimi i fundit i KS të OKB-së është i rëndësishëm dhe meriton të përshëndetet. Mirëpo, tani më shumë se kurrë Kosovës dhe lidershit atje i duhet vigjilencë, unitet, dhe njëzershmeri politike të paktën sa i përket statusit përfundimtar të vendit, lënë anash përkohësishtë ndasitë partiako-politike. Dhe, me maturinë e duhur politike, angazhimin e diplomatëve ekspertë në këtë proces, mbetet vetëm pak vend për të dyshuar se Kosova do të arrijë të realizojë aspiratën e saj të kahmotëshme për shtetësi.

Mirëpo, fillimi i “negociatave” për statusin përfundimtar të Kosovës nuk prejjudikon asnjë zgjidhje. Sikur faktori politik i Kosovës që po qëndron këmbëngulës në kërkesën për pavarësi, ashtu po vepron edhe kundërshtari politik në këto “negociata” – Beogradi që po qëndron këmbëngulës në kërkesën për ruajtje të “sovrانيتit dhe integritetit territorial” të Unionit Serbi dhe Mali i Zi. Në të njejtën kohë, edhe Prishtina edhe Beogradi e dijnë fare mirë se as njëra e as tjetra nuk kanë të drejtë vetoje në këtë proces. Dhe, nëse dikush ka të drejtë vetoje, atëherë ajo do të jetë vet bashkësia ndërkombëtare, që më në fund edhe do të mund të imponojë një zgjidhje mbi supet e Prishtinës dhe të Beogradit. Tutje, cfarëdo zgjidhje e imponueshme që mund të vije nga bashkësia ndërkombëtare, pasi që sic dihet pozicionet e fortifikuara të dy palëve kryesore në këtë proces janë diagonalisht dhe polarisht të kundërta, do të mund të shënojë edhe fundin e fillimit të një mandati të ri ndërkombëtar në Kosovë.

Kush do të dal fitues nga procesi i definimit të statusit përfundimtar të Kosovës?

Për fituesin, nuk ka nevojë aspak të spekulohet – por për humbësin, nuk duhet aspak koment: Beogradi do të marrë kartën e kuqe në këtë lojë, duke u përshëndetur njëherë e përgjithëmonë me të gjitha ëndërrat e kaherëshme për dominim në Kosovë. Mirëpo, duke u nisur nga historia e zhvillimeve politike në rajon dhe vecanërisht në

Kosovë në relacion me bashkësinë ndërkombëtare, nuk është edhe largë mendjes së shëndoshë të mendohet se Kosova nga ky proces do të dal me *shtetësi*.

Pra, një hap që nuk mund të anashkalohej gjatë këtij procesi është dhënia e shtetësisë Kosovës. Mirëpo, a do të thotë automakisht se me marrjen e shtetësisë Kosova e fiton edhe pavarësinë? Fatkeqësisht, shtetësia si e tillë nuk prejudikon statusin e vendit në arenën ndërkombëtare, pasi që kjo shtetësi mund të lihet e varur, apo e kushtëzuar, sic po flitet shumë. Dhe, një shtetësi e tillë, nuk do të sillte pavarësi dhe sovranitet për Kosovën, edhe pse në shumë aspekte Kosova do të ishte sikur të gjitha shtetet tjera të rajonit. Thjeshtë thenë, Kosova do të bëhet shtet, por a do të jetë ky shtet Republika e Kosovës apo “EU Commonwealth of Kosovo” (Komonuelthi Evropian i Kosovës)?

Republika e Kosovës

Edhe pse e themeluar dhe e proklamuar herët në vitet e 1990-ta, Republika e Kosovës ende mbetet për t’u njohur nga bashkësia ndërkombëtare. Por, varësisht nga rrjedha e procesit të definimit të statusit përfundimtar të Kosovës, Republika e Kosovës mund të jetë edhe rezultati final. Atëherë, Kosova do të ishte Kosova që duhet të jetë – shtet i pavarur, sovran, dhe i njohur ndërkombëtarisht.

Se sa janë shancet që Kosova të arrijë të dale me trofenë e Republikës nga ky proces i udhëhequr dhe i kontrolluar nga bashkësia ndërkombëtare, e cila vazhdimisht po thërret për kompromis e negociata, nuk dihet. Të bësh kompromis, sic thot populli thjeshtë do të thot “të lëshosh pe.” Por a mundet delegacioni kosovar të lëshojë pe? Dhe, nuk e quaj Grupi Negociator, sic është proklamuar zyrtarisht në Kosovë, sepse vet ky emërtim është konotacion i gatishmërisë dhe përshtatshmërisë me kërkesat ndërkombëtare për “negociata.” Dhe, nuk është fare e besueshme dhe e arsyeshme që Grupi kosovar mund të “negociojë” në çështjen e statusit përfundimtar të vendit – ata ose insitojnë në pavarësi, ose jo. Pavarësia nuk mund të negociohet. Tani, mund të argumentohet se mund të negociohet për çështje tjera dhe për atë arsye, ky është quajtur Grupi Negociator. Mirëpo, mos të harrojmë se ky grup është krijuar enkas për të prezentuar Kosovën në procesin e definimit të statusit përfundimtar, dhe për këtë proces,

nuk mund të ketë negociata. Negociatat për çështje tjera mund të pasojnë vetëm pas definimit të statusit përfundimtar – pra njohjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran.

Prandaj, lidhshipi në Kosovë duhet të jetë tejte i kujdesshëm në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me këtë proces delikat që në dorë do të ketë fatin e ardhshëm të Kosovës. Në të njëjtën kohë, edhe vet populli në Kosovë duhet të jetë përkrahës deri në maksimum I këtij procesi që të arrijë të krijoj një ambient paqe, dinjiteti, dhe respektimi njerëzor, para të cilin as bashkësia ndërkombëtare nuk do të ketë mundësi t'i mbyllë syt.

Pra, partneriteti lidhshipi-popull është mëse i nevojshëm që Grupit Kosovar të Statusit, sic do ta quaja Grupin Negociator, t'i jepen sa më shumë argumente dhe sa më shumë hapsirë manovrimi pozitiv politik për të arritur deri të zgjidhja optimale për Kosovën – pavarësia e plotë, Republika e Kosovës, shtet sovran dhe i njohur ndërkombëtarisht.

EU Commonwealth of Kosovo (EUCK) – Komonuelthi Evropian i Kosovës

Fjala *Commonwealth* (komonwelth) nga anglishtja do të thotë “komb, apo shtet që qeveriset nga populli.” Është krijuar për t'iu referuar Shtetit Anglez dhe qeverisë së tij pas vdekjes së mbretit Charles I më 1649 deri në restaurimin e monarkisë më 1660, duke përfshirë edhe kohën e protektoratit të periudhës prej 1653 deri më 1659. Mirëpo, edhe pse krijuar para thujse katër qind viteve më parë, kjo formë e qeverisjes ende zotëron edhe sot në vendet më moderne dhe demokratike, si në SHBA, për shembull. Disa nga shtetet e SHBA-ve edhe sot kanë statusin e Komonuelthit, sic janë Virginia (Virgjina), Kentucky (Kentaki), etj. Pra, këto janë shtete të barabarta me të gjitha shtetet tjera në Bashimin e Shteteve të Amerikës.

Ndërkohë, definimi politikisht më korrekt i fjalës apo i kësaj mënyre të shtetësisë dhe qeverisjes do t'i referohej një entiteti politik, shtetëror, të pavarur, vetëqeverisës, që është në aleance vullnetare me ndonjë parter të përbashkët, apo autoritet qëndror.

Shembuj të tillë janë Puerto Rico, që është Komonuelth Amerikan, apo edhe Kanada që është ende e lidhur vullnetarisht me Fronin Mbretëror Anglez.

Duke lexuar në mes rreshtave të deklaratave të shumta të faktorëve ndërkombëtar në lidhje me statusin përfundimtar të Kosovës, mund të mësohet se gjithënjë e më shumë po rrëshqitet drejt një lidhje më të fuqishme të Kosovës me Bashkimin Evropian sesa me OKB-në, pra për një rrëshqitja nga mandati i OKB-së në të ardhmen në një mandat evropian. Në këtë rast, si zgjidhje apo si përcaktim për statusin përfundimtar të Kosovës do të dilte Komonuelthi Evropian i Kosovës (EU Commonwealth of Kosovo – EUCK).

Mirëpo, edhe kjo zgjidhje, sipas vet definimit të fjalës Komonuelth, do të sillte shtetësi për Kosovën, sikur edhe vetëqeverisje, por do të mbante një lidhje apo asociim me Brukselin, të paktën për një periudhë kohore gjerësa Kosova krejtësisht do të ishte gati të bëhej anëtare e plotë e vet Bashkimit Evropian, dhe në atë cast, statusi i Kosovës do të ndryshonte në Republika e Kosovës, krejtësisht e pavarur dhe anëtare e barabartë në BE.

Mirëpo, pasi që me cdo kusht, bashkësia ndërkombëtare do të insistojë në një prani substanciale në Kosovë dhe me kompetenca kuptimplota ekzekutive, por jo edhe sa të UNMIK-ut, tani, atëherë EUCK do të mund të jetë një opcion për të cilin bashkësia ndërkombëtare do të punojë ta implementojë, duke bërë që Kosova të mos ketë pavarësi krejtësisht të plotë, por të njejtën kohë të mos ketë asfarë lidhje me Beogradit, por të jetë shtetë i afiliuar me BE-në.

Pasi që prezenca e BE-së në Kosovë ka ekzistuar për vite tani, dhe pasi që Kosova është në përdorim të Euro-s si bankënote zyrtare vendore, dhe mbi të gjitha pasi që Kosova, sikur edhe të gjitha vendet tjera të Ballkanit janë të orientuara drejtë anëtarësimi në BE, atëherë Kosova veq i plotëson të gjitha prerekuizitat e të bërit Komonuelth Evropian. Në këtë mënyrë, do të përshpejtohej edhe anëtarësimi i saj i plotë në BE. Kosova do të adoptonte ligjet e BE-së dhe kushtetutën e ardhëshme Evropiane. Po ashtu, Kosova do të bëhej me doemos shtet multi-etnik, sikur të gjitha shtetet e BE-së, dhe në

këtë mënyrë do të zgjidhjej çështja e minoriteteve në Kosovë. Ndërkohë, Kosova do të kishte një Gardë Kombëtare, ashtu sic kanë edhe Puerto Riko, për shembull, por jo edhe ushtri të rregulltë. Qytetarët e Kosovës do të ishin Kosovarë, dhe jo “të pashtetësi” sic janë tani nën mandatin e UNMIK-ut.

Pra, një EUCK do të ishte një hap tranzitor në mes UNMIK-ut dhe pavarësisë së plotë të Kosovës. Por, ky hap do të ishte shumë më i përshtatshëm se çfarëdo pavarësie tjetër e kushtëzuar, pasi që si EUCK, Kosova do të hecete shumë më shpejt drejtë anëtarësimin në BE. Këtë thenë, BE nuk do të kishte opcion tjetër pos përkrahjes së plotë të zhvillimit të Kosovë në nivel të barabartë me anëtarët tjerë, më të rinjë, të BE-së. Kështu, Kosova do të mund të arrinte statusin e anëtarit të barabartë të BE-së ndoshta edhe më shpejtë se vendet tjera të rajonit.

Pavarësia e Plotë e Menjëherëshme

Këtë thenë, nuk dua që të merret se në ndonjë mënyrë po argumentoj në favor të EUCK-së, këtij opinioni personal, përkundër pavarësisë së plotë. Fuqimisht jam përkrahës i pavarësisë së plotë dhe të menjëherëshme për Kosovën, që si rezultat të procesit të definimit të statusit përfundimtar do të sillte njohjen e Republikës së Kosovës.

Mirëpo, duke pare zhvillimet në arenën ndërkombëtare dhe duke vlerësuar realisht mundësitë që do t’i ofrojë bashkësia ndërkombëtare për Kosovën, atëherë ia vlenë që të përgatitemi edhe për atë që nuk e preferojmë. Por, nuk duhet harruar se nga dy të këqija, duhet zgjedhur atë më të voglën.

Në fund, më duhet të them se dëshiroj që e ardhmja të sjellë një realitet që të gjithë shqiptarët e Kosovës e duan – pavarësinë e plotë të vendit – dhe që ajo që unë e kam quajtur EUCK të mos bëhet realitet.

Autori është duke magjistruar në Administratë Publike dhe Marrëdhënie (Zhvillim) Ndërkombëtare në Shkollën Postdiplomike të Qeverisjes John F. Kennedy të Universitetit të Harvardit në Cambridge, SHBA. Ai është nderuar me tillutin më prestigjioz për kandidatët e magjistraturës Kennedy Fellow të kësaj shkolle me renome botërore.

Ju lutem mos hezitoni që komentet tuaja në lidhje me këtë publikim t'i dërgoni përmes faqës sonë në internet (nën rubrikën "Komentet"). Komentet tuaja janë gjithëherë të mireseardhura.

The Bislimi Group
www.bislimi.org